

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 8964 rep.
Nr. 1611 Kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH
Neni 23 i ligjit 7632 date 4.11.1992

Sot ne daten 08 Nentor 2005 (dymije e pese), u paraqiten personalisht para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne Bulevardin " Zog I" ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, palet kontraktuese si vijon :

SHITESI : Z.Fation BEJKO, i biri i Skenderit dhe i Donikes, lindur me 16.11.1975 dhe banues ne Tirane, Rruga " Dibres", Pall.15, Ap.14, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. 0937670.

Z.Skender BEJKO, i biri i Nekiut dhe e Melihase, lindur me 20 Korrik 1940 dhe banues ne Tirane, ne adresen e mesiperme, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja.

BLERESI : Z.Gledjon REHOVICA, i biri i Tomorit dhe i Minushes, lindur me 21 Dhjetor 1977 dhe banues ne Berat, Lagje "10 Korriku", madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 1098055.

Te dy palet me kerkuan redaktimin e kontrates shitjes kuotave qe vijon:

Shoqeria „JORA“ Sh.P.K. eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.27011, date 21.01.2002, shoqeri e cila nuk ka asnje ndryshim ne statutin dhe aktin e saj te themelimit qe nga krijimi i saj. Ortaket e shoqerise jane : Fation Bejko qe zoteron 60% te kapitalit fillestar dhe Skender Bejko, qe zoteron 40% te kapitalit fillestar. Shoqeria ka kapital fillestar 100.000 leke, afati i veprimtarise eshte eshte i percaktuar 10 vjet, Selia e saj eshte ne rrugen e „Dibres“, Pallati 15, Ap.14 , administrator eshte Z. Fation Bejko dhe drejtues teknik Z.Skender Bejko.

Shoqeria e ushtron aktivitetin per zbatim, per projektim dhe per drejtim punimesh (supervizion e kolaudim) ne fushen e ndertimit, shitblerje pasuri te tundeshme e te patundeshme, drejtim e udhezim objektesh, prodhim dhe tregetim te mallrave te ndryshme industriale, elektro shtepijake, prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit dhe lendeve te para te tyre, punime dur alumini, hekuri etj.

Ortaket e shoqerise Fation Bejko dhe Skender Bejko, me deshiren e tyre te lire e te plote deklarojne se te gjitha kuotat e tyre prej 100% dhe kapitalin themeltar te shoqerise ia shesin bleresit Gledjon Rehovica, i cili deklaroi se eshte dakord qe t'i bleje ato.

Me marreveshje te perbashket te dy palet kane percaktuar se çmimi per shitjen e 100% te kuotave eshte 100.000 (njeqind mije) leke, shume e cila eshte likujduar totalisht nga bleresi Gledjon Rehovica jashte zyres noterise.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale, shitesit Fation Bejko dhe Skender Bejko e humbasin çdo te drejte ne shoqerine "JORA" shpk dhe ortak i vetem i shoqerise behet bleresi Gledjon Rehovica.

Shitja e kuotave dhe kapitalit eshte e aprovuar ne mbledhjen e ortakut te Vetem Nr.1 date 08 Nentor 2005.


Kontrates i bashkangjitet vendimi per regjistrimin si person juridik dhe fotokopja e licences se Ministrise se Rregullit te Teritorit dhe Turizmit Nr.4399/1 date 28.03.2003.

Sa me siper perpilohet nga une noterja kjo kontrate shitje kuotash, e cila ju lexohet paleve me ze dhe mbasi gjendet konforme vullnetit te tyre te lire e te plote e firmosin rregullisht ate, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITESIT

Z.Fation BEJKO

Z.Skender BEJKO



BLERESI

Z.Gledjon REHOVICA



NOTERE
RUKO SAKO

